



492  
At 26.01.2026

Librazhd më: 23.01.2026

**NJOFTIM**

**“PËR MBLEDHJEN E KËSHILLIT TË BASHKISË”**

Z.znj. \_\_\_\_\_

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 53 pika 2 dhe pika 4, ju njoftojmë se ditën e **Premte, datë 30.01.2026**, ora 10:00 do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak për muajin **Janar** 2026. Mbledhja do të zhvillohet te Salla e Këshillit në Bashki me këtë rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 23.12.2025.
3. **P/Vendim** “Mbi kriteret e përdorimit të fondit të kushtëzuar për Bllok Ndihmën Ekonomike deri në 6% për vitin 2026.
4. **P/Vendim** “Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 % periudha dhjetor 2025”.
5. **P/Vendim** “Plani i Sigurisë Publike 2026-2027 bashkia Librazhd”.
6. **P/Vendim** “ Për një shtesë në v.k.b nr 110 datë 23.12.2025 Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 të bashkisë Librazhd dhe programit përfundimtar buxhetor aftmesë 2026-2028”.
7. **P/Vendim** “Përdorim fondi social”.
8. **P/Vendim** “Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nënpunësve civil e të punonjësve Administrativ të bashkisë Librazhd dhe Institucioneve të varësisë”.
9. **P/Vendim** “ Për dhënie ndihmë financiare”.
10. **P/Vendim** “Për miratimin e aktmarreveshjes riparimit e urës metalike tip “Baily” në fshatin Xhyrë Njesia Administrative Hotolisht Bashkia Librazhd nr.8423 date 24.12.2025”.
11. **P/Vendim** “Për miratimin e dokumentacionit tekniko-ligjor dhe dhënien e ndihmës financiare për familjen e Znj. Blerina Dobrenji, banore e lagjes Nr.1 qytet bashkia Librazhd, banesa e së cilës ka pësuar fatkeqësi natyrore ( Rënie zjarri në banesë dt.09.12.2025).
12. **P/Vendim** “ Për miratimin e listës së ngastrave ku do të lejohet kullotja dhe kositja e barit për vitin 2026”.
13. **P/Vendim** “ Për miratimin e listës së ngastrave që mund të jepen në përdorim të fondit pyjor e kullosor publik”.
14. **P/Vendim** “ Për miratimin për dhënie me qira të tokës bujqësore të pandarë”

15. **P/Vendim** “ Përcaktimin e rregullave të hollësishme për mënyrën e paraqitjes së aplikimit dhe procedure Administrative për njohjen si posedues jopronar”.
16. **P/Vendim** “Propozim për dhënie hapsire publike për aktivitet restorative dhe ose rekrativ(kioske),rinovim kontrate”.
17. **P/Vendim** “Për miratimin e planit të punës ,planit të konsultimeve dhe planit të buxhetit të këshillit bashkiak Librazhd për vitin 2026”.
- Raport mbi Veprimtarinë e Këshillit Bashkiak per Vitin 2025 dhe Transparencën në Procesin e Vendimrjes.

**18. Të ndryshme:**

- *Ditën e enjte datë 29.01.2026 ora 10:00 të mblidhen Komisionet te Salla e Këshillit Bashkiak.*

KRYETARI I KËSHILLIT

Mitat BICAKU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LIBRAZHDI  
KËSHILLI BASHKIAK

PROCEVERBALI I MBLEDHJES 23.12.2025

- I mbajtur sot më datë 23.12.2025 në mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak Librazhd.
- Pasi u lexua rendi I ditës nga Kryetari i Këshillit të gjithë të pranishmit janë dakort **18 vota pro**.  
Mitat Biçaku, Dashnor Hysa, Zenel Bahiti ,Fatbardha Qatja, Bledi Koçi ,Fiqirete Alliu, Adelina Alla, Ndriçim Doda, Arjana Çekrezi, Kujtim Albrahimi, Silvana Hoxha, Veli Terziu, Kastriot Gurra, Habil Biçaku, Arben Hoxha, Flutur Kojku, Ilir Kuka, Erjola Albrahimi (**Këshilltarët e pranishëm**).
- Miratohet procesverbali i mbledhjes së datës 26.11.2025 me të gjitha votat e të **pranishmëve 18 vota pro**.  
Mitat Biçaku, Dashnor Hysa, Zenel Bahiti ,Fatbardha Qatja, Bledi Koçi ,Fiqirete Alliu, Adelina Alla, Ndriçim Doda, Arjana Çekrezi, Kujtim Albrahimi, Silvana Hoxha, Veli Terziu, Kastriot Gurra, Habil Biçaku, Arben Hoxha, Flutur Kojku, Ilir Kuka, Erjola Albrahimi (**Këshilltarët e pranishëm**).

**Miratohet fillimi I mbledhjes me këtë rend dite si më poshtë vijon:**

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 26.11.2025.
3. **P/Vendim** “Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 % periudha nëntor 2025”.
4. **P/Vendim** “Për miratimin e paketës fiskale (taksave dhe tarifave vendore), në Bashkinë Librazhd për vitin 2026”.
5. **P/Vendim** “ Për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë Librazhd për vitin 2026”.
6. **P/Vendim** “ Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nënpunësve civil e të punonjësve Administrativ të Bashkisë Librazhd dhe Istitucioneve të varësisë.”
7. **P/Vendim** “Për miratimin e listës së projekteve prioritare në infrastrukturën e Bashkisë Librazhd për vitin 2026-2028”

8. **P/Vendim** “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 të bashkisë Librazhd dhe programit përfundimtar buxhetor afatmesëm 2026-2028”.
9. **P/Vendim** “Për miratimin e kalendarit të programit buxhetor afatmesëm 2027-2029 dhe vitit buxhetor 2027”.
10. **P/Vendim** “ Për miratimin e listës së familjeve që plotësojnë kushtet për programin e subvencionimit të qirasë për vitin 2026”.
11. **P/Vendim** “Mbi ndarjen e bursave për nxënësit e viteve të para të Arsimit Profesional për vitin shkollor 2025-2026”.
12. **P/Vendim** “Për miratimin për dhënie bursash për nxënësit e arsimit Parauniversitar ne shkollat publike ne bashkinë Librazhd.

### **13. Të ndryshme:**

1. **P/Vendim** “ Për dhënie në përdorim të fondit pyjor e kullosor publik”
2. **P/Vendim** “Për miratimin e rinovimit të kontratës së “Shërbimit publik për pranimin ,depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve të bashkisë Librazhd” në Impjantin e trajtimit të mbetjeve Urbane të Qarkut të Elbasanit midis Bashkisë Librazhd dhe shoqërisë “Eco-Elb”sh.a.
3. **P/Vendim** “Për miratimin e marrveshjes së bashkëpunimit midis Ashk dhe Bashkisë Librazhd”.

### **Fillimi i mbledhjes:**

1. **P/Vendim** “Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 % periudha nëntor 2025”.

Nuk ka pyetje nga këshilltarët;

- **Hidhet në votim ky P/Vendim;** Miratohet me të gjitha votat e të pranishmëve **18 vota pro.**  
Mitat Biçaku,Dashnor Hysa,Zenel Bahiti ,Fatbardha Qatja,Bledi Koçi ,Fiqirete Alliu,Adelina Alla,Ndriçim Doda,Arjana Çekrezi,Kujtim Albrahimi,Silvana Hoxha,Veli Terziu,Kastriot Gurra,Habil Biçaku,Arben Hoxha,Flutur Kojku,Illir Kuka,Erjola Albrahimi (**Këshilltarët e pranishëm**).
- 2. **P/Vendim** “Për miratimin e paketës fiskale (taksave dhe tarifave vendore),në Bashkinë Librazhd për vitin 2026”.

**Këshilltari Zenel Bahiti e merr fjalën;**

Dje në mbledhjen e komisioneve ne e kemi diskutuar dhe me Drejtoreshën dhe e falenderojmë për përgatitjen e Paketë Fiskale për vitin 2026. Çfarë ndryshimesh ka kjo paketë nga viti i kaluar ose më saktë çfarë keni ndryshuar?

#### **Këshilltarja, Fatbardha Qatja e merr fjalën;**

E kam lexuar me vëmendje p/vendimin e paketës fiskale dhe relacionin dhe shikoj një punë të mire bërë nga ana juaj.Kam disa pyetje ne lidhje me paketëm fiskale;

- Si i kontrolloni bizneset e reja?
- Çfarë benefitesh kanë qytetarët e Librazhdit nga kjo Paketë Fiskale?
- Sa humbje sjelle taksa e ndërtesës?
- Shikoj dhe lehtësirat fiskale,tarifat favorizuese ,më duken mire që menaxhohen tarifat në mënyrë të rregullt.
- Pagesa është e rregullt midis qytetarëve kudrejt bashkisë?

#### **Këshilltari Bledi Koçi e merr fjalën;**

- Në lidhje me vlerën e taksave , ne qytet është 0.17% dhe në gjithë zonën 0.2%,si na e shpjegoni këtë?
- Pse e keni ndryshuar ose me saktë mos e keni gabim pasi leja për kryrje punimesh ka qënë 50 minjë leke të vjetra dhe shikoj që e keni çuar 200 minje leke të vjetra?
- Dhe diçka tjetër në lidhje me ndërtimet e reja,psë në një tabele ju thoni 1.5% e vlerës së ndërtimit dhe diku tjetër e shkruani 1% të vlerës së ndërtimit,realisht sa duhet të paguaj një qytetar kur ndërton?
- Mesa di unë çmimi i references për qytetin është ulur,punime që nuk kërkojnë leje ndërtimi e shikoj që e keni rritur?

#### **Këshilltari Veli Terziu e merr fjalën;**

Kisha diçka për taksën e banesës.Si do ta verifikoni kur nuk ka Certificate Pronësie?

#### **Këshilltari Ndriçim Doda e merr fjalën;**

Unë kam diçka në lidhje me taksën e tokës dhe e shikoj që nuk ka ndryshuar.

Si e barazoni taksën e tokës?Njësoj për çdo fshat?

- **Drejtoresha e të Ardhurave Vendore ,Lindita Shuli e merr fjalën;**

**Përshëndetje të gjithëve!**

**Në mënyrë të përmbledhur propozojmë këto shtesa dhe ndryshime në Paketën Fiskale 2026.**  
**Për Taksa Vendore**

Taksa dhe cmimet e taksës së ndërtesës ;

- Per vitin 2026 kemi reduktim deri 35 % te çmimit referencë në njësitë administrative jashtë qytetit.
- Numri i neteve të shërbimit hotelier nga 300 ditë në vit në 300 dite për një person për mos deklarim të numrit të personave të akomoduar .

### **Për Tarifa Vendore**

- Te lehtësirat fiskale tek pika nr.1 nga 50% në vitin e parë në 0 tarifa për vitin e parë .
- Te lehtësirat fiskale tek pika nr.2 nga 25% në dy vitet e para ,në 50 % tarifa në dy vitet e para.
- Te pika Nr.4 dhe Nr. 5 janë lehtësira të miratuara në ligj.
- Për tarifën e shërbimit të pastrimit pika 1.2shtohet citimi i bizneseve si ,IT Software,dhe bizneset e ndërtimit pamvarësisht adresës në qkb.
- Për tarifën e shërbimit të pastrimit pika 1.19 shtohet per bizneset ushqimore+fruta perime, bar – restorante dhe ndahet nga pika 1.2
- Për tarifën e shërbimit të pastrimit pika 1.22 shtohet citimi i bizneseve si ,IT Software dhe tarifa nga 6 mijë në 7 mijë pasi kostoja është më e lartë në njësitë administrative .
- Shtohet te pika 1.24 zëri transporti.
- Hiqet pika 1.26 pasi është i njëjti përshkrim me pikën 1.25.
- Janë shtuar zonat e shërbimit te pastrimit ( sipas dokumentacionit dhe informacionit nga sektori juridik per sherbimin e pastrimit), jane shtuar 5 fshatra per sherbimin e pastrimit si : në Hotolisht Fshat , Vulçan , Polis Gostimë 2, Prevall, dhe Steblevë me nje numer prej 800 familje
- Per tarifën e ndricim gjelberimit tek biznesi eshte bere ndarje tarife dhe jo ndryshim tarife .
- Tek pika 3 tarifa për hapësirat publike Zona A nga 200 lek /m2 në muaj në 300 lek /m2 në muaj.
- Tek pika 3 tarifa për hapësirat publike Zona B nga 150 lek /m2 në muaj në 200 lek /m2 në muaj.
- Tek pika 3 tarifa për hapësirat publike Zona C nga 100 lek /m2 në muaj në 150 lek /m2 në muaj
- Tek pika 3 tarifa për hapësirat publike Zona Ç nga 60 lek /m2 në muaj në 100 lek /m2 në muaj
- Tek pika 10 .8 shtohet tarifëpër marrje me qera për palestrën 10,000 lekë/rast.
- Tek pika 13.5, tarifa për zgjatje orari të kohës normale të punës për bar- kafe .restorante nga 1000 lek /në ditë, bëhet në 2000 lek /ditë. .
- Shtohet pika 1.30 tarifa e pastrimit per bar restorantet ne njesite administarative .
- Hiqet pika 1.26 paketa 2025

**Zyrat në Bashkinë Librazhd nuk ofrojnë shërbim nëse dokumentacioni i kërkeses nuk shoqërohet edhe me vërtetimin e Drejtorsë e të Ardhurave Vendore të Bashkisë Librazhdi cili konfirmon pagesën e Taksave dhe Tarifave Vendore si për familjaret ashtu edhe për bizneset.**

- Afati i njoftimit të taksapaguesve është 31.05.2026
- Afati pagesave 30.09.2026 për personat juridike , shpk , date 30.11.2026 për prsonat fizike ndërtesatsocial ekonomik , të dhëna me qera , ambulantë, dhe 31.12.2026 , familjaret.
- Mbas datës së përcaktuar për likuidim do të llogaritetkamatë vonesë sipas ligjit 9920 datë 19.05.2008 “ Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë ” .

*Ju faleminderit dhe shpresoj në miratimin tuaj !*

- **Hidhet në votim ky P/Vendim;** Miratohet me të gjitha votat e të pranishmëve **18 vota pro.**  
Mitat Biçaku,Dashnor Hysa,Zenel Bahiti ,Fatbardha Qatja,Bledi Koçi ,Fiqirete Alliu,Adelina Alla,Ndriçim Doda,Arjana Çekrezi,Kujtim Albrahimi,Silvana Hoxha,Veli Terziu,Kastriot Gurra,Habil Biçaku,Arben Hoxha,Flutur Kojku,Illir Kuka,Erjola Albrahimi **(Këshilltarët e pranishëm).**
- 3. **P/Vendim** “ Për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë Librazhd për vitin 2026”.

**Drejtoresha e Burimeve Njerëzore,Nadire Biçaku e merr fjalën;**

Përshëndetje të gjithve!

Numri i punonjësve të Istitucionit për vitin 2026 do të jetë 456 punonjës.Duhet të theksojmë që numri I punonjësve për vitin 2026 nuk ka ndryshime,është në të njëjtin nivel me vitin 2025.

- **Hidhet në votim ky P/Vendim;** Miratohet me të gjitha votat e të pranishmëve **17 vota pro.**  
Mitat Biçaku,Dashnor Hysa,Zenel Bahiti ,Fatbardha Qatja,Bledi Koçi ,Fiqirete Alliu,Adelina Alla,Ndriçim Doda,Arjana Çekrezi,Kujtim Albrahimi,Silvana Hoxha,Veli Terziu,Kastriot Gurra,Arben Hoxha,Flutur Kojku,Illir Kuka,Erjola Albrahimi **(Këshilltarët e pranishëm).**

4. **P/Vendim** “ Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar,të nënpunësve civil e të punonjësve Administrativ të Bashkisë Librazhd dhe Istitucioneve të varësisë.”

**Këshilltarja, Fatbardha Qatja e merr fjalën;**

- Sa i përket p/vendimit të pagave shikoj një shpërndarje jo të drejtë.Dhe për specialistët me arsim të mesëm ndarjen nuk e shikoj reale,funksioni është specialist.Pse nuk I keni ndarë të gjithë 47 000 minjë lekë.Ju dolët dhe me performance të mirë dhe shikoj jua keni ulur pagën përsëri. Pse ka ndodhur kjo gjë? Pse nuk e motivoni punonjësën? Unë jam kundër këti p/vendimi që pagat e punonjësve të ulen.I lini të shijojnë pagën e tyre.Përgjegjës grupi në Sektorin e Patrasferushme është me pagë 45 000 minjë lekë dhe si ka mundësi që keto që janë muartorë,elektracist,hidraulike etj jane me paga të ndryshme,a nuk është më e mira për te gjithë që pagën bazë ta kenë 50 000 minjë lekë siç është dhe vendimi I qeverisë. Unë jam e mendimit të ndihmoni punonjësit dhe mos jua ulni pagën.

**Sekretari i Përgjithshëm,Bajram Pishkashi e merr fjalën;**

Efektet financiare për këtë p/vendim fillojnë nga 1 Janari kshuqë në qoftë se vkm e re vjen së shpejti mendoj e lëmë të hapur si p/vendim dhe me pas pasqyrojmë dhe pagën minimale,prandaj ne nuk e kemi futur në këtë p/vendim pasi sjemi njohur akoma se çfarë përmbanë vkm e re.

**Këshilltari Bledi Koçi e merr fjalën;**

Ky p/vendim vjen me risi dhe këto paga sot ulen.Këtu preken më shumë specialistët sot.Ka një vkm që është miratuar që paga minimale do jetë 50.000 minjë lekë.Në date 19 dhejtor është botuar dhe vkm për pagën minimale që sdo ketë page nën 50.000 minnjë lekë.Në këtë që po miratojmë sot e miratojmë për vitin 2026.Ju me këtë p/vendim sot jua ulni pagat punonjësve.Për tu habitur se si ju akoma vazhdoni me një page 40.000 minjë lekë.Sa është efekti financiar për këto ulje që po bëni sot?

**Këshilltari Veli Terziu e merr fjalën;**

A ju përgjigjet diploma me vendin e punës?

**Kryetari i Bashkisë,Mariglen Disha e merr fjalën;**

Përshëndetje! Në lidhje me vendimin e pagave jam munduar që pagat ti çojmë në maksimale, por për këtë vit pagat zinin 60% të buxhetit dhe e shikuam të arsyshme që pagat ti çonim deri në 80% ,të shikojmë me vonë mbasë bëjmë përsëri ndonjë ndryshim.Në lidhje me pagën minimale

ngelemi në pritje të vkm së re,për të bërë dhe ne ndryshimet e duhura.Në lidhje me pyetjen e këshilltarit Terziu,ne jemi munduar që 90% e punonjësve ti përshtaten dhe arsimit që kanë mbaruar.

- **Hidhet në votim ky P/Vendim;** Miratohet me **12 vota pro dhe 4 kundër.**
- **Votat pro;**  
Mitat Biçaku,Dashnor Hysa,Zenel Bahiti ,Fiqirete Alliu,Adelina Alla,Ndriçim Doda,Arjana Çekrezi ,Silvana Hoxha, Kastriot Gurra,Arben Hoxha,Flutur Kojku, Erjola Albrahimi.
- **Votat kundër;**  
Fatbardha Qatja,Illir Kuka,Bledi Koçi,Veli Terziu.

**5.P/Vendim** “Për miratimin e listës së projekteve prioritare në infrastrukturën e Bashkisë Librazhd për vitin 2026-2028”

**Këshilltari Dashnor Hysa e merr fjalën;**

Si çdo here ne e kemi miratuar listen e investimeve prioritare por unë kam disa mendime ose shtesa në lidhje me këtë p/vendim.Duhet të futet rruga e babjes loti i dytë që të shkoj deri lart ,rruga e fshatit Qarrisht besoj se nuk ka zonë më të bukur se parku kombëtar i Shebenikut,mund ta quajm fiks një Theth i dytë.

**Këshilltari Ilir Kuka e merr fjalën;**

Përshëndetje! Kam disa pyetje; Në lidhje me rrugën Funarës-Zdrajsh kua sipas informacioneve që kam ju kan kaluar dhe disa pagesa.Pse rruga akoma nuk ka përfunduar?Në lidhje me programin e çatave. A vërtet kanë përfitur ato familje që janë në nevojë apo janë futur kot.Se nga informacionet që kam ,kanë përfitur persona që nuk rrinë fare në fshat dhe ju është rregulluar çatia.

- **Hidhet në votim ky P/Vendim;** Miratohet me të gjitha votat e të pranishmëve **16 vota pro.**  
Mitat Biçaku,Dashnor Hysa,Zenel Bahiti ,Fatbardha Qatja,Bledi Koçi ,Fiqirete Alliu,Adelina Alla,Ndriçim Doda,Arjana Çekrezi ,Silvana Hoxha,Veli Terziu,Kastriot Gurra,Arben Hoxha,Flutur Kojku,Illir Kuka,Erjola Albrahimi (**Këshilltarët e pranishëm**).

**6.P/Vendim** “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 të bashkisë Librazhd dhe programit përfundimtar buxhetor afatmesëm 2026-2028”.

**Kryetari i Bashkisë,Mariglen Disha e merr fjalën;**

## **TE NDERUAR ANETARE TE KESHILLIT BASHKIAK LIBRAZHD !**

Sot miratojme buxhetin me te madh qe Bashkia Librazhd ka pasur ndonjehere.

Ne vitin 2023 kur kam marre mandatin si Kryetar Bashkiebuxheti i Bashkise Librazhd ka qene 654,659,440 leke

Buxheti i vitit 2026 eshte 934,740,019 leke. Reth 220 milion leke te reja me shume.

Vitin 2025 e mbyllim me shume investime ne asfaltime, rikonstruksione shkollash, rikualifikime urbane, investime ne kanale vaditese, parqe lodrash, mbareshtime pyjesh etj.

Vetem ne vitet 2024-2025 jane asfaltuar rruge ne fshatrat Polis, Spathar, Vehcan, Vulcan, Kokreve, Librazhd Qender, Funares, Zdrajsh, Prevalle dhe Zgosht Borove.

Ne vitin 2026 angazhohem qe me buxhetin qe presim te miratohet sot por dhe me ndryshimet buxhetore ne janar dhe ne vijim do asfaltohen rreth 13 rruge fshatrash dhe rruge ne qytetin Librazhd.

Rruget qe jane prioritet asfaltimi per vitin 2026 jane ne fshatrat Polis Gostime, Vulcan faza 2, Xhyre, Kuturman Marinaj, Prevalle Dranovice.

Ne muajin janar 2026 dhe ne vijim do kerkohet miratimi dhe investimi ne rruget e fshatrave Lagjia e Brazhdajve Dorez, Floq rruga e zallit Zdrajsh Verri, Letem, Vehcan faza 2, Kokreve faza 2, Librazhd Katund faza 2, Mirake shkolla Gjovac.

Investimin ne lagjen e madhe te Stacionit te Trenit me asfaltime, shtrime me pllaka, kanalizime, ndricim publik, gjelberim dhe lulishte.

Asfaltime te rrugeve ne lagjen e Shese dhe varrezat e deshmoreve.

Ne kete buxhet miratojme ndertimin e bazamenteve per fushen e re te sportit duke eleminuar problemin me te madh per fushe stervitore per ekipin e sportit "Sopoti".

Prioritet do te jete edhe investimi ne fasadat e pallateve ne qytet, izolimi i tarracave si dhe ndertimi i cative uniforme te pallatet ne sheshin kryesor.

Cdo vit kemi investuar ne shkolla te reja. Pas perfundimit te Gjimnazeve Polis dhe Dorez eshte duke u investuar ne shkollen 9-vjecare "Vilson Blloshmi". Lajmi i mire eshte qe dy shkolla te reja i shtohen Bashkise Librazhd 9-vjecare Togeze dhe 9-vjecare Lunik. Kjo fale lobimit te mire dhe fitimit te projekteve nga donatore te huaj. Punimet fillojne ne vitin 2026.

Si cdo vit prioritet kemi edhe sistemin vadites. Investojme ne rikonstruksionin dhe riparimet pjesore ne te gjitha segmentet e kanaleve ku ka probleme. Furnizojme me tuba vaditje te gjithe fermeret qe kane veshtiresi me ujin.

Eddhe ne 2026 do kryhet investime nga Drejtoria e Puneve Publike ne rikualifikime urbane ne te gjitha qendrat e fshtrave dhe lagjeve te qytetit ne shtrim me pllaka, ndricim publik dhe stola.

Ne 2025 jane duke u ndertuar 59 cati me projektin per permisimin e kushteve te banimit. Ne 2026 do aplikojme e fitojme me shume familje.

Viti 2026 do te jete viti i mbareshtimit te pyjeve, pyllezimit dhe kurimit te pishes ne Bashkine Librazhd.

Ne fushen sociale ne vitin 2026 ndihmojme me bonus qiraje 74 familje. Miratojme bursa per 76 e nxnes ne shkolla profesionale dhe shkolla publike ne bashki.

Angazhohem qe realizimi i buxhetit ashtu si ne vitin 2025 te jete ne masen 100 %.

Angazhohem ne lobimin dhe aplikimin ne cdo projekt qe institucionet qendrore apo ato te huaja shpallin. Bashkepunimi me institucionet si Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Ministrite ka qene i shkelqyer.

Fale ketij bashkepunimi FSHZH e ka klasifikuar Librazhdin si bashki me projekte te mira dhe me investime te sigurta.

Kjo ishte nje permbledhje e buxhetit te vitit 2026.

Ftoj te gjitha anetaret e keshillit bashkiak ta votojne PRO miratimit te buxhetit.

Faleminderit !

#### **Këshilltari Bledi Koçi e merr fjalën;**

Buxheti i Bashkise vertet eshte nje buxhet I madh.Te tabela nr 5 janë investime qe nuk jane te permendura te kjo table.Investimet per vitin 2026 nuk i shikoj fare te parshikuara.Shikoj rrugën Librazhd-Librazhd Katund do shkojë deri te çezma.Do jetë faze tjetër apo perfundimi I asaj qe ka nisuar? Tarifa e pastrimit sa vjen dhe rritet po kjo nga se ndodh?

#### **Këshilltarja, Fatbardha Qatja e merr fjalën;**

Ashtu si Kryetari i Bashkisë tha që buxheti I bashkisë është vërtet ne rritje.Pse nisni projekte të reja ku akoam ka investime që nuk kanë mbaruar?Cilët rrugë përfundojnë realisht në vitin 2026?Kur keni pas kontrollin (KLSH) a ka lënë rekomandime apo detyra dhe a janë të përfshira në këtë buxhet?

#### **Këshilltari Veli Terziu e merr fjalën;**

Në lidhje me rrugen e Mirakë Katund çfarë po bëhet pasi nuk po e shikoj ,do bëhet si investim apo jo?

### **Këshilltari Kastriot Gurra e merr fjalën;**

Vërtetë që buxheti i bashkisë është në rritje dhe si çdo vit që vjen do vazhdojë të ketë rritje. Me këtë ritim që bashkia po ndjek besoj shumë shpejt dhe rrugët e fshatrave do mbarojnë. Kam një dy kërkesa dhe besoj është në të mirë të komunitetit. Kërkoj ndërhyrje për gjimnazin e qytetit pasi shtesa që bëmë me parë akoma nuk është plotësuar sic duhet, dhe palestra e shkolles ka ngelur akoam pa përfunduar pasi ajo është një ndër palestrat më të mira në shkallë qarku dhe do jetë një gjë shumë e mirë të paiset me mjetet e duhura, ku ato me permasat që ka mund të bëhen ndeshje të nivelit të lartë.

### **Kryetari i Bashkisë, Mariglen Disha e merr fjalën;**

Në lidhje me pyetjet e drejtuara;

Ne muajin janar 2026 dhe ne vijim do kërkojmë miratimi dhe investimi në rrugët e fshatrave Lagjia e Brazhdajve Dorez, Floq rruga e zallit Zdrajsh Verri, Letem, Vehcan faza 2, Kokreve faza 2, Librazhd Katund faza 2, Mirake shkolla Gjovac. Unë mundohem që të bëjmë sa më shumë investime, të gjitha rrugët që janë në proces besoj mbrenda 2026 do kenë përfunduar. Në lidhje me Klsh ka lenë disa masat të vogla që nuk kanë dëme ekonomike dhe drejtorit përkatëse po i rregullojnë siç duhet. Në lidhje me pyetjen e Ilirit, drejtoju me kërkesë me shkrim për të marrë përgjigje. Për pyetjen e Veliut siç e thash dhe më lart shumë shpejt fillojnë punimet për Mirakë Katund. Kërkesa shumë të drejta ato të Kastriotit do mundohemi që të marrim ndonjë fond nga Fondi Shqipëtar i Zhvillimit që të mundësojmë rikostruksionin e Gjimnazit Ibrahim Muça dhe palestrën e saj. Në lidhje me mensën e qytetit besoj shumë shpejt do e vendosim në punë nga donatorët e Katarit.

- **Hidhet në votim ky P/Vendim;** Miratohet me të gjitha votat e të pranishmëve **16 vota pro.**  
Mitat Biçaku, Dashnor Hysa, Zenel Bahiti, Fatbardha Qatja, Bledi Koçi, Fiqirete Alliu, Adelina Alla, Ndriçim Doda, Arjana Çekrezi, Silvana Hoxha, Veli Terziu, Kastriot Gurra, Arben Hoxha, Flutur Kojku, Ilir Kuka, Erjola Albrahimi (**Këshilltarët e pranishëm**).

**7.P/Vendim** “Për miratimin e kalendarit të programit buxhetor afatmesëm 2027-2029 dhe vitit buxhetor 2027”.

Nuk ka pyetje nga këshilltarët;

- **Hidhet në votim ky P/Vendim;** Miratohet me të gjitha votat e të pranishmëve **16 vota pro.**

Mitat Biçaku, Dashnor Hysa, Zenel Bahiti , Fatbardha Qatja, Bledi Koçi , Fiqirete Alliu, Adelina Alla, Ndriçim Doda, Arjana Çekrezi , Silvana Hoxha, Veli Terziu, Kastriot Gurra, Arben Hoxha, Flutur Kojku, Ilir Kuka, Erjola Albrahimi (**Këshilltarët e pranishëm**).

**8. P/Vendim** “ Për miratimin e listës së familjeve që plotësojnë kushtet për programin e subvencionimit të qirasë për vitin 2026”.

**Këshilltari Bledi Koçi e merr fjalën;**

Kjo puna e bonusit të qerasë më duket është bërë si një traditë pasi braktisin fshatin dhe vine ne qytet dhe bonusin ja paguan bashkia dhe në rregull janë pastaj. Jam I mendimet që emrat e listës të shikohen me kujdes. Të lihet lista e hapur që në qoftë vjen dhe ndonjë tjetër dhe është mundësia të shikohet.

**Këshilltari Zenel Bahiti e merr fjalën;**

Në qoftë se vërtetë ka abuzime të mbledhet komisioni këshillit dhe të verifikojnë familjet.

**Kryetari i Bashkisë, Mariglen Disha e merr fjalën;**

Kush ka ardhur ka plotësuar dokumentacionin në rregull dhe specialistët e zyrës kanë bërë verifikimet në jemi munduar ti ndihmojmë të gjithë.

**Sekretari i Përgjithshëm, Bajram Pishkashi e merr fjalën;**

Në lidhje me bonusin e qerasë besoj që është program I mire për të ndihmuar familjet vërtetë në nevojë, ky program financohet 70% nga Ministria dhe 30% nga ana e Bashkisë. Sot me erdhën nja dy familje që me zor kishin plotësuar dokumentacionin mendoj ti përfshijmë tek lista fituese.

- **Hidhet në votim ky P/Vendim;** Miratohet me të gjitha votat e të pranishmëve **15 vota pro.**

Mitat Biçaku, Dashnor Hysa, Zenel Bahiti , Fatbardha Qatja, Bledi Koçi , Fiqirete Alliu, Adelina Alla, Ndriçim Doda, Arjana Çekrezi , Silvana Hoxha, Veli Terziu, Arben Hoxha, Flutur Kojku, Ilir Kuka, Erjola Albrahimi (**Këshilltarët e pranishëm**).

**9. P/Vendim** “Mbi ndarjen e bursave për nxënësit e viteve të para të Arsimit Profesional për vitin shkollor 2025-2026”.

Nuk ka pyetje nga këshilltarët;

- **Hidhet në votim ky P/Vendim;** Miratohet me të gjitha votat e të pranishmëve **15 vota pro.**

Mitat Biçaku, Dashnor Hysa, Zenel Bahiti , Fatbardha Qatja, Bledi Koçi , Fiqirete Alliu, Adelina Alla, Ndriçim Doda, Arjana Çekrezi , Silvana Hoxha, Veli Terziu, Arben Hoxha, Flutur Kojku, Ilir Kuka, Erjola Albrahimi (**Këshilltarët e pranishëm**).

**10.P/Vendim** “Për miratimin për dhënie bursash për nxënësit e arsimit Parauniversitar ne shkollat publike ne bashkinë Librazhd.

**Këshilltari Zenel Bahiti e merr fjalën;**

Duhet vërtet rishikuar lista pasi ka nxënës për arsye ekonomike po braktisin shkollën.

**Drejtoresha e Arsimit dhe Kulturës, Elona Koçi e merr fjalën;**

Ne listen do ta rishikojmë përsëri por për efekt kohe sollëm për miratim këtë listë.

- **Hidhet në votim ky P/Vendim;** Miratohet me të gjitha votat e të pranishmëve **15 vota pro.**

Mitat Biçaku, Dashnor Hysa, Zenel Bahiti , Fatbardha Qatja, Bledi Koçi , Fiqirete Alliu, Adelina Alla, Ndriçim Doda, Arjana Çekrezi , Silvana Hoxha, Veli Terziu, Arben Hoxha, Flutur Kojku, Ilir Kuka, Erjola Albrahimi (**Këshilltarët e pranishëm**).

**Të ndryshme:**

1. **P/Vendim** “ Për dhënie në përdorim të fondit pyjor e kullosor publik”

**Këshilltari Bledi Koçi e merr fjalën;**

Çfarë ndryshimi ka ky p/vendim nga ai I kaluari dhe çfarë statusi ka?

**Kryetari I Këshillit Mitat Biçaku merr fjalën;**

Dokumentacioni që ju është kërkuar në mbledhjen e pare ka ardhur I plot dhe besoj nuk ka kundërshtime.

- **Hidhet në votim ky P/Vendim;** Miratohet me **13 vota pro dhe 1 kundër .**

**Votat pro;**

Mitat Biçaku, Dashnor Hysa, Zenel Bahiti , Bledi Koçi , Fiqirete Alliu, Adelina Alla, Ndriçim Doda, Arjana Çekrezi , Silvana Hoxha, Veli Terziu, Arben Hoxha, Flutur Kojku, Erjola Albrahimi.

**Votat kundër;**

Ilir Kuka

2. **P/Vendim** “Për miratimin e rinovimit të kontratës së “Shërbimit publik për pranimin ,depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve të bashkisë Librazhd” në Impjantin e trajtimit të mbetjeve Urbane të Qarkut të Elbasanit midis Bashkisë Librazhd dhe shoqërisë “Eco-Elb”sh.a.

Nuk ka pyetje nga këshilltarët;

- **Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet me 13 vota pro dhe 1 kundër .**

**Votat pro;**

Mitat Biçaku,Dashnor Hysa,Zenel Bahiti ,Bledi Koçi ,Fiqirete Alliu,Adelina Alla,Ndriçim Doda,Arjana Çekrezi ,Silvana Hoxha,Ilir Kuka,Arben Hoxha,Flutur Kojku, Erjola Albrahimi.

**Votat kundër;**

Veli Terziu

3. **P/Vendim** “Për miratimin e marrveshjes së bashkëpunimit midis Ashk dhe Bashkisë Librazhd”.

Nuk ka pyetje nga këshilltarët;

- **Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet me të gjitha votat e të pranishmëve 14 vota pro.**

Mitat Biçaku,Dashnor Hysa,Zenel Bahiti ,Bledi Koçi ,Fiqirete Alliu,Adelina Alla,Ndriçim Doda,Arjana Çekrezi ,Silvana Hoxha,Veli Terziu,Arben Hoxha,Flutur Kojku,Ilir Kuka,Erjola Albrahimi (**Këshilltarët e pranishëm**).


SEKRETARI I KËSHILLIT

Elson MALLUTA



KRYETARI I KËSHILLIT

Mitat BIÇAKU



P/Vendim: 570/1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LIBRAZHD  
SEKTORI I SHËRBIMEVE SOCIALE

**PROJEKT/VENDIM**

Nr. .... Datë .....2026

**Mbi kriteret e përdorimit te fondit te kushtezuar per Bllok Ndhimen  
Ekonomike deri ne 6% per vitin 2026**

Mbështetur në ligjin 139/2015 për "Vetqeverisjen Vendore", Ligji 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar me Ligjit nr 137/2020, bazuar në nenin 21 të ligjin 57 datë 18.07.2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë",ku citohet shprehimisht:Këshilli bashkiak miraton kriteret për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit, bazuar në vlerësimin social-ekonomik të kryer nga administratori shoqëror. Sektori i Shërbimit Social,i propozon Këshillit Bashkiak Librazhd "Miratimin e kriterëve specifike për familjet që do të përfitojnë Ndhimë Ekonomike me 6% e fondeve të kushtëzuara të Bllok-Ndhimës për vitin 2026.

**VENDOSI :**

Te përfshihen në skemën e fondit 6% ,familjet të cilat janë shpallur me pikë të pamjaftueshme nga sistemi elektronik i Nd.Ek, dhe mbartin problematikat e mëposhtme social-ekonomike:

- Te jene familje me kryefamiljare Gra dhe ne gjendje te dobet ekonomike
- Te jene familje qe kane ne perbrjen e tyre Persona me Aftesi te kufizuara apo Invalide Pune
- Te jene familje ekstremisht te varfëra qofte edhe kur kane nje automjet te regjistruar por nuk e kane ne perdorim dhe nuk e kane cregjistruar ne Drejtorine Rajonale te automjeteve per arsye ekonomike.
- Te jene familje me femije jetim ose ne kujdestari te ketyre femijeve
- Te jene familje me probleme te ndryshme Sociale,dhune ne familje,process divorci etj.
- Familje qe kane pesuar fatkeqsi natyore.

Per familjet qe do te trajtohen me ndihme ekonomike duhet te jete kryer paraprakisht vlersimi social ekonomik ne familje nga administrator shoqeror sipas formularit tip te verifikimit dhe qe ruhet ne dosjen e deokumentave te aplikantit prane njesise vendore dhe qe i bashkengjitet Pr/Vendimit te ardhur nga Njesite Administrative.

Pergj.Sektorit Sherb.Social  
Rexhep Shaka

**KRYETARI I BASHKISË  
MARIGLEN DISHA**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LIBRAZHDI  
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Adresa : Sheshi "Gjorg Golemi" Nr.T&l 0514 / 2352,

e-mail:info@bashkialibrazhd.gov.al

**RELACION**

**Mbi kriteret e perdorimit te fondit te kushtezuar per Bllok Ndhmen  
Ekonomike deri ne 6% per vitin 2026**

Ashtu sic eshte parashtruar edhe ne Projekt-Vendim ne cdo fillim viti Keshilli Bashkiak miraton kriteret per dhenien e Ndhimes Ekonomike per familjet qe aplikojne ne sistemin elektronik te Ndhimes Ekonike por qe ne Vendimin final qe vjen nga sistemi nuk vijne familje perfituse por familje qe nuk kane marre piket e mjaftushme nga vlersimi i indikatoreve te deklaruar nga vete familja gjate aplikimit.

Referimi i ketyre familjeve per te perfituar nga fond i kushtezuar i bllok ndihmes behet nga Administratoret Shoqerore te Ndhimes Ekonomike ne sistemin elektronik.

Ligji ka parashikuar qe jo te gjitha familjet qe dalin me pike te pamjaftushme mund te referohen per ta perfituar ndihmen ekonomike.

Kriteret e miratuara nga Keshilli Bashkiak do te jene baze per percaktimin e familjeve qe do te referohen,pervecse Administratori Shoqerore i Ndhimes Ekonomike ne Njesi duhet te bej vlersimin social-ekonomik te cdo familje dhe ta vlersoje ate ne se eshte familje ne nevojë!

**Ne kriteret e parashtruara ne Projekt-Vendim kemi vendosur familjet qe kane me shume probleme sociale,qe jane ekstremisht te varfera, te varfera dhe ne nevojë,familjet me kryefamiljare Gra,te divorcuara,me dhune ne familje, familje qe kane persona me aftesi te kufizuara ,invalide pune ,familje me femije jetim e probleme te tjera sociale-ekonomike-shoqerore.**

Bazuar ne kriteret e miratuara nga Keshilli Bashkiak,nga vlersimi social-ekonomik i bere nga Administratori Shoqerore,familjet referohen ne sistem dhe nga cdo Njesi Administrative qe ka familje te tilla pregatitet Projekt-Vendim me relacion per cdo familje dhe sillet prane Sektorit te Ndhimes Ekonomike per te bere Projekt Vendimin e Pergjithshem te Bashkise mbi perfitimin e Ndhimes Ekonomike nga ky fond.

Pergj /Sekt.Sherb.Social  
Rexhep Shaka

P/Vendimi 57 = 2

①

K.H. '24'



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
NJËSIA ADMINISTRATIVE  
NDIHMJA EKONOMIKE DHE SHËRBIMET SOCIALE

**PROJEKT-VENDIM**

Nr.25 Datë 20.01.2026

**“Mbi dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i Kushtëzuar 6%”  
(Periudha: DHJETOR 2025)**

Në mbështetje të Ligjit Nr.57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, Vendim Nr.597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të Ndhmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për Ndhmën Ekonomike” Kreu IV, Vendim Nr. 956, datë 7.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve dhe detajeve të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e Ndhmës Ekonomike”

Nisur sa më lart nga verifikimi i sistemit elektronik i Ndhmës Ekonomike rezulton se janë refuzuar (që nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme) **75** Familje, dhe propozohet:

- 1-Të përfitojnë Ndhmë Ekonomike nga fondet e kushtëzuara 6%: Gjithsej **75** Familje me një fond: **310,423** lekë. Vlera e ndihmës **258,903** lekë, vlera e energjisë **51,520** lekë
- 2-Të mos përfitojnë për arsye të mos plotësimit të kriterëve nga fondi i kushtëzuar 6% nuk ka familje.
- 3-Familjet përfituese sipas listës bashkëngjitur.
- 4-Ngarkohen për zbatimin e këtij Projekt-Vendimi Administratorët Shoqërorë të Ndhmës Ekonomike në Njësitë Administrative.
- 5- Ky Projekt-Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së Vendimit

**Përgjegjës në Sektorin e Ndhmës Ekonomike**

Rexhep Shaka

**KRYETARI I BASHKISË  
MARIGLEN DISHA**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
NJËSIA ADMINISTRATIVE  
NDIHMA EKONOMIKE DHE SHËRBIMET SOCIALE

**RELACION**

Nr.25 datë 20.01.2026

**“Mbi Dhënien e Ndhmës Ekonomike nga Fondi i Kushtëzuar 6%”  
(Periudha: DHJETOR 2025)**

Në mbështetje të Ligjit Nr.57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, Vendim Nr.597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të Ndhmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për Ndhmën Ekonomike” përcaktohet qarte se kush mund ta përfitojë kete ndihme nga fondi i kushtëzuar 6% i bllok ndihmës ekonomike.

E rëndesishme është që familjet që nuk klasifikohen si përfituse në sistemin elektronik të ndihmës ekonomike me pikë të pa mjaftushme të verifikohen saktësisht nga Administratori Shoqërorë i Ndhmës Ekonomike duke e vlersuar nga ana ekonomike, sociale, shoqërore dhe duke pasur parasysh kriteret që janë miratuar në Këshillin Bashkiak ta vlersojë familjen nëse duhet apo jo që të klasifikohet si familje që duhet të përfitojë ndihmë ekonomike nga fondi 6%.

Nisur sa më lartë nga verifikimet në sistem dhe paraprakisht vlersimi social-ekonomik ne familje nga Administratori Shoqërorë, nuk janë shpallur përfitues nga sistemi i pikëzimit 75 Familje dhe propozohet:

1-Të përfitojnë Ndhmë Ekonomike nga fondet e kushtëzuara 6% Gjithsej 75 familje.

2- Te mos përfitojnë nuk ka familje.

**Njesitë Administrative:**


1. Njësia Administrative Qytet	26 Familje me fond	103,783 lekë
2. Njësia Administrative Hotolisht	12 Familje me fond	60,161 lekë
3. Njësia Administrative Polis	9 Familje me fond	28,353 lekë
4. Njësia Administrative Qendër	19 Familje me fond	78,608 lekë
5. Njësia Administrative Orenjë	9 Familje me fond	39,518 lekë

**Totali si Bashki 75 familje me fond 310,423 lekë.**

## Relacion për Familjet e Refuzuara

- Familjet që nuk janë rekomanduar për tu trajtuar nga fondi 6 % nuk ka.

Përgjegjës në Sektorin e Ndhmës Ekonomike  
Rexhep Shaka





## FONDI 6%

Periudha: DHJETOR 2025

Bashkia Librazhd

Nr	Emri i Aplikantit	NID	Statusi aplikimit	Vlera e përlogarit për fondin 6%		Kompensi mi i Energjisë	Totali	Numri	
								anëtarëve	
1	Reshit Beqir Hysa	G81126034S	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2		
2	Kujtim Ymerli Polisi	H00409064A	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	3		
3	Avni Beqir Bogdani	H00106009U	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	5,227	1,288	6,515	3		
4	Xhemile Xhelo Alliu	G75616178K	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2		
5	Ahmet Adem Menalla	G40628018J	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2		
6	Vera Mehmet Dada	I75404018N	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1		
7	Fatbardha Dalip Kurti	G45320047G	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146	1,288	4,434	1		
8	Eduart Xhevit Pali	I10524158W	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	4,792	1,288	6,080	4		
9	Ymer Xhaferr Kala	G31020023L	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,049	1,288	4,337	3		
10	Sabri Hajdar Stafa	G71012046N	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703		3,703	2		
11	Lutfije Ali Roçi	E25406026F	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146	1,288	4,434	1		
12	Sadete Osman Çekrezi	H95623178U	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	5,940	1,288	7,228	3		
12	<b>Total Njësia Administrative: Hotolisht</b>			<b>45,993</b>	<b>14,168</b>	<b>60,161</b>	<b>27</b>		
1	Shyqyrie Belul Billoshmi	G65107079J	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2		
2	Tahire Qamil Balla	G35812017F	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1		
3	Vule Kadri Topi	F75710021A	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1		
4	Farije Sefedin Topi	G05328025M	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1		
5	Qamil Selman Ferra	F80501032B	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146	1,288	4,434	1		
6	Olisi Nazmi Dosku	H50108018L	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178		2,178	1		
7	Fatmira Hysen Gjorga	G15420041E	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1		
8	Kujtim Hasan Buzra	F90826008C	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2		

9	Jonida Faik Hunçi	I75522027N	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
10	Leonard Enver Brasha	J60806018C	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178		2,178	1
11	Piro Ferit Halili	H70320023A	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	3
12	Arjan Mevlut Meta	I20327028C	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178		2,178	1
13	Nasibe Ismail Hunçi	G45229211O	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
14	Artur Isuf Guga	G80721009F	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703		3,703	2
15	Lulzim Dylber Kazazi	G30612046C	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	2
16	Alma Nexhat Kola	G45703011C	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
17	Rajmonda Luan Zylali	I26014010H	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	5,940	1,288	7,228	2
18	Qanije Refat Brasha	F95520031H	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
19	Sabije Livan Zyka	F66018008Q	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146	1,288	4,434	1
20	Ramazan Tahir Brahja	G10225030V	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	2
21	Ardi Osman Elezi	I61115008U	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
22	Bujar Bajram Bahidi	G80316015M	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	1,525	1,288	2,813	2
23	Albert Refat Brahja	I60413014P	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,267		3,267	2
24	Deje Muharem Coha	G45915009K	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
25	Lulzime Nebi Roçi	J55223019R	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	5,940		5,940	3
26	Enkeleda Ferit Braho	J45310022U	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	9,900		9,900	4
26	<b>Total Njësia Administrative: Librazhd</b>			<b>89,615</b>	<b>14,168</b>	<b>103,783</b>	<b>42</b>
1	Dashurije Islam Kiçi	F85303158B	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
2	Astrit Xhevit Murtini	H00401317G	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
3	Ismet Shaip Balliu	F61209003T	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	6,752	1,288	8,040	4
4	Bashkim Reshit Biba	G70701144N	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	2
5	Kadife Abaz Balliu	G15710021S	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
6	Enver Mexhit Kaca	F80502085T	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	4,158	1,288	5,446	3
7	Zanushe Shefqet Haskurti	G76003005L	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
8	Nadire Maksut Luka	E85901096E	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
9	Hajrije Beqir Lala	E75615085D	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
9	<b>Total Njësia Administrative: Orenje</b>			<b>33,078</b>	<b>6,440</b>	<b>39,518</b>	<b>17</b>
1	Sadik Riza Zaimi	G30325115M	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703		3,703	2
2	Afërdita Rexhep Tanushi	G46125056D	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146	1,288	4,434	1

3	Shyqyri Seit Alimeta	E20222004Q	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	4,752		4,752	2
4	Xhevahire Islam Zaimi	G95321059Q	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178		2,178	1
5	Sabrie Sadik Shata	G95605100F	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178		2,178	1
6	Mexhit Nuredin Stërmugu	F90224131N	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703		3,703	2
7	Hava Hamit Hasani	G65823039B	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178		2,178	1
8	Nadire Mustafa Kasa	H26223016N	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,049		3,049	3
9	Xhevrije Shahin Xhakeri	G65325034C	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178		2,178	1
9	<b>Total Njësia Administrative: Polis</b>			<b>27,065</b>	<b>1,288</b>	<b>28,353</b>	<b>14</b>
1	Qerim Xhemal Dishani	H00517020G	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
2	Fatmir Belul Dosku	G30901018U	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703		3,703	2
3	Suela Federit Shkurti	I65602016S	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
4	Ramadan Dalip Allushi	E20103061F	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
5	Fatmir Kadri Hoxha	G40320186W	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
6	Isuf Jonuz Seferi	D60826014S	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146	1,288	4,434	1
7	Sanije Shefqet Alija	G65125222I	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
8	Mereme Mehmet Çerri	C75607020R	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
9	Ymer Tafil Alla	G10625082P	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
10	Tefta Asllan Hoxha	G86222012E	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	-00	2,178	1
11	Trandafille Sulejman Çela	H05505324G	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
12	Suzana Ramazan Almina	J45904016K	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	5,940		5,940	2
13	Xhane Osman Kojku	G65105008W	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146	1,288	4,434	1
14	Sanie Qamil Hoxha	G15614006P	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
15	Gani Bajram Faqolli	G40720092D	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
16	Sabire Xhemal Shuli	A55716002R	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
17	Fiqirete Ymer Rruplli	H85916021Q	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178		2,178	1
18	Flamur Osman Dosku	G30729006Q	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
19	Qamile Musa Çela	G55730044W	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146	1,288	4,434	1
19	<b>Total Njësia Administrative: Qender - LIBRAZHD</b>			<b>63,152</b>	<b>15,456</b>	<b>78,608</b>	<b>28</b>
75	<b>Totali Bashkisë</b>			<b>258,903</b>	<b>51,520</b>	<b>310,423</b>	<b>128</b>

Përgjegjës në Sektorin e Ndhmës Ekonomike

Rexhep Shaka



q/vendimi  
510 = 3



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA LIBRAZHD

PROJEKT - VENDIM

Nr..... datë .....

**PLANI I SIGURISË PUBLIKE 2026–2027 BASHKIA LIBRAZHD**

Bazuar në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji 125/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar Ligji 124/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.221/04.02.2010 për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe VKM nr. 334, datë 17.02.2011, mbi Mekanizmin e Koordinuar të Referimit për dhunën në familje, Ligjin nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, Sekretariati Teknik i KVSP paraqet Planin e Veprimit të Sigurisë Publike 2026–2027. Plani i Sigurisë Publike i Bashkisë Librazhd synon të adresojë nevojat dhe të drejtën e qytetarëve për një mjedis të sigurt, të forcojë strukturat vendore përgjegjëse dhe të përmirësojë shpërndarjen, cilësinë dhe llojshmërinë e ndërhyrjeve të sigurisë, duke rritur ndjesinë e sigurisë dhe besimin publik. Plani është hartuar përmes një procesi konsultimi me përfaqësues të institucioneve vendore, Policinë e Shtetit, strukturat e emergjencave civile, shoqërinë civile, ofruesit e shërbimeve dhe grupet në nevojë, për të garantuar një vlerësim sa më afër nevojave reale dhe mundësive për t’i adresuar ato nga aktorë të ndryshëm. Këshilli Bashkiak i Bashkisë Librazhd, pasi shqyrtoi materialet shoqëruese dhe propozimin e Kryetarit të Bashkisë,

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë ne parim “Planin e Veprimit 2026–2027 të Këshillit Vendor të Sigurisë Publike (KVSP) të Bashkisë Librazhd”, si dokument orientues për objektivat, masat, përgjegjësit dhe afatet në fushën e sigurisë publike në territorin e bashkisë.
2. Të ngarkohen për zbatimin e këtij plani Sekretariati Teknik dhe strukturat përkatëse të Bashkisë Librazhd, në bashkëpunim me institucionet dhe të gjithë aktorët, sipas kompetencave ligjore.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë nga miratimi në Këshillin Bashkiak dhe publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Librazhd.

Sekretariati Teknik  
Rexhep Shaka

Kryetari i Bashkisë  
Mariglen Disha



**REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA LIBRAZHD**

**Relacion për**

**Miratimin e Planit të Veprimit 2026–2027 të Këshillit Vendor të Sigurisë Publike  
(KVSP) në Bashkinë Librazhd**

Të nderuar këshilltarë,

Plani i Veprimit 2026–2027 i KVSP-së mbështetet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i cili përcakton kompetencat e bashkive për ofrimin e shërbimeve komunitare, ruajtjen e rendit dhe bashkërendimin ndërinstitucional në territor. Bashkëpunimi me Policinë e Shtetit bazohet në Ligjin nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit” dhe aktet nënligjore për policimin në komunitet. Menaxhimi i emergjencave civile udhëhiqet nga Ligji nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”. Parandalimi dhe menaxhimi i dhunës në familje mbështetet në Ligjin nr. 9669/2006, i ndryshuar, dhe VKM nr. 334, datë 17.02.2011 mbi Mekanizmin e Koordinuar të Referimit (MKR).

Bashkia Librazhd ka ngritur dhe funksionalizuar KVSP-në, me bashkërendim ndërinstitucional mes bashkisë, Policisë së Shtetit, institucioneve arsimore e shëndetësore, shërbimeve sociale, gjyqësorit, zjarrfikëses, si dhe aktorëve të shoqërisë civile, rinisë dhe biznesit lokal. Ndërveprimet e deritanishme kanë identifikuar nevoja për: (i) rritje të koordinimit praktik në terren; (ii) parandalim proaktiv të rreziqeve prioritare (siguria rrugore, mjediset arsimore, dhuna në familje, fatkeqësitë natyrore); (iii) kanale të aksesueshme raportimi dhe komunikim publik; (iv) sistematizim të të dhënave për vendimmarrje dhe llogaridhënie.

Plani është pregatitur duke patur si parime udhëheqëse:

- Qasje gjithëpërfshirëse dhe e bazuar në prova.
